

# NIVELI FILLESTAR [A2]

## Detyra me shkrim

### 1. Lexoni tekstin dhe gjeni variantin e saktë të përgjigjes:

Ky është Edsoni. Edsoni është shoku im. Ai është mësues i letërsisë në shkollën e mesme:”Liria”. Kjo është Dea. Dea është dentiste. Ajo punon në një klinikë dentare pranë universitetit tonë. Motra e Deas quhet Ina. Ajo është parukiere dhe punon në një sallon bukurie në qendër të qytetit. Vëllai i tyre është Ani. Ai është biznesmen në sektorin e ndërtimit. Tani është në Romë. Po merr pjesë në një panair lidhur me zhvillimin e ndërtimit në qendrat urbane. Prindërit e tyre jetojnë në Vlorë. Ata janë pensionistë.

Kjo është Eda. Ajo është shoqja ime. Eda është profesore e letërsisë në universitet. Vëllai i saj quhet Armir. Ai është projektues dhe merret me projektet e qendrave tregtare. Motra e tyre quhet Ana. Ajo është inxhinierë mjedisi. Punon në një organizatë joqeveritare për çështjet e mjedisit. Tani Ana është në Bruksel në një konferencë për ndotjen e ajrit në kryeqytetet e mëdha. Prindërit e tyre jetojnë në Greqi me vëllain e vogël që punon në Athinë si kuzhinier.

Unë jam Elda. Jam fizikante dhe punoj në Institutin e Fizikës Bërthamore. Motra ime është Teuta. Ajo është biologe dhe punon në një qendër kërkimore pranë Universitetit të Tiranës. Vëllai ynë quhet Driton. Ai është muzikant, kompozitor. Kënga fituese e festivalit të fundit ishte kënga e kompozuar prej tij. Prindërit tanë jetojnë bashkë me ne. Babai ynë është oficer, ndërsa mamaja është edukatore kopshti.

#### a) Ani është biznesmen dhe po merr pjesë :

- Në një panair lidhur me zhvillimin e ndërtimit në qendrat urbane.
- Në një konferencë për ndotjen e ajrit në kryeqytetet e mëdha.
- Në një takim për zonat turistike
- Në Athinë për të takuar prindërit.

#### b) Ana është inxhinierë mjedisi. Ajo punon

- në sektorin e ndërtimit
- si organizatore takimesh dypalëshe (bilaterale) për mjedisin
- në Ministrinë e Mjedisit
- në një organizatë joqeveritare për çështjet e mjedisit.

**c) Teuta është biologe dhe punon**

- në Fakultetin e Shkencave të Natyrës.
- në një qendër kërkimore pranë Universitetit të Tiranës.
- në një organizatë joqeveritare në Bruksel.
- Në një klinikë mjeksore.

**d) Profesioni i Dritonit është:**

- Mësues
- Biolog
- Kompozitor
- Këngëtar

**e) Prindërit e Deas, Inës dhe Anit jetojnë:**

- në Athinë me djalin e vogël.
- në Vlorë.
- në Tiranë me fëmijët e tyre.
- në Sarandë me vajzën e vogël.

**f) Vëllai i Edës është:**

- kompozitor
- mësues i letërsisë.
- projektues dhe merret me projektet e qendrave tregtare
- inxhinier mjedisi

**2. Vendosni parafjalën e duhur në vend të pikave (për, me).**

Kam disa ide interesante ..... problemin që kemi në punë.

Ka disa vite që çdo mëngjes pi një gotë qumësht ..... mjaltë.

Gjatë gjithë kohës mendoj ..... familjen që e kam kaq larg.

Klea ..... motrën e saj po mendojnë një festë surprizë ..... shoqen e tyre.

Të lutem, shënimet e tua bëji ..... stilolaps të kuq.

**3. Në vend të pikave vendosni ndajfoljet që mungojnë: *aty, lart, diku, atje, matanë, djathtas, këtu majtas.***

- Shkolla e vajzës sime ndodhet.....
- Më prit..... se do të vij shpejt.
- ..... është shtëpia e motrës sime.
- Djali im është ..... tani.
- Shokët e mi do të shkojnë..... pas drekës në Durrës.
- Shiko....., zogjtë fluturojnë shpejt.
- Muzeu ndodhet.....
- Ik..... dhe mos u vono rrugës!

**4. Zgjidhni formën e saktë të foljes.**

Olsa me fëmijët të shtunën

a. do të vizitojmë  
b. do të vizitoj                      kopshtin botanik.  
c. do të vizitojnë

Për atë mbrëmje unë

a. zgjodhëm  
b. zgjodha                      një fustan të gjatë.  
c. zgjodhi

Prindërit e mi

a. do të rezervoni  
b. do të rezervojnë                      një apartament për pushimet verore.  
c. do të rezervosh

**5. Vini përemrat pronorë në vetën II, numri shumës.**

Ju u takuat me shoqen \_\_\_\_\_. Unë e di që tashmë ju keni zgjidhjet \_\_\_\_\_. Afër shkollës \_\_\_\_\_ ndodhet një park shumë i bukur. Një mbrëmje, erdhi në shtëpinë \_\_\_\_\_ një shoku im. Kush do ta rregullojë gabimin \_\_\_\_\_? Sa e bukur është palltoja \_\_\_\_\_. Idesë \_\_\_\_\_ nuk do t'i ndryshoj asgjë. Ajo lexoi para të gjithëve, poezinë \_\_\_\_\_. Më duket se atyre u pëlqeu mendimi \_\_\_\_\_.

**6. Zgjidhni formën veprorë apo joveprorë.**

Unë mund të \_\_\_\_\_ gabuar, por ashtu m'u duk. Ju duhet të \_\_\_\_\_ mësuar deri në darkë. Shiu duhet të \_\_\_\_\_ pushuar tashmë. Ndërtuesit mund të \_\_\_\_\_ përfunduar punimet. Rrobat duhet të \_\_\_\_\_ tharë. Uljet e çmimeve duhet të \_\_\_\_\_ filluar. Fëmijët e tu duhet të \_\_\_\_\_ rritur. Për këtë shfaqje, vendet në teatër mund të \_\_\_\_\_ zënë. Besoj se të gjithë duhet të \_\_\_\_\_ ngrënë.

**7. Shkruani një intervistë mbi një çështje sociale që ju shqetëson.**

---

---

---

---

---

---

---